

Raporti Vjetor 2025



Shkurt, 2026



www.dplus.org

Zbuloni më shumë rreth publikimeve tona më të fundit, lajmeve dhe infografikave online.

 [@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)  [@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)

 [@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)  [@Democracy.Plus](https://www.youtube.com/channel/UC...)

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92,
Kati IV, Prishtinë, 10000 Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Rreth Demokraci Plus

05

Fuqizimi i të rinjve për integritet, përvojë dhe transformim digjital

07

Mbështetja e Programit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë

12

Monitorimi i prokurimit publik

14

Fuqizimi i Qytetarëve dhe Reforma Administrative në Kosovë

23

Fuqizimi i grave fermere

25

Monitorimi i projekteve publike me Auditimin Social

27

Përpjekjet për parandalimin e përhapjes së lajmeve të rreme

29

Raportimet dhe ndreqjet në platformën ndreqe.com

33

Partnerët dhe donatorët

38

Rreth Demokraci Plus

Ne jemi organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2016 me përkushtimin për të ndërtuar një shoqëri demokratike në Kosovë. Misioni ynë përqëndrohet në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset politike, promovimin e llogaridhënies dhe ndikimin në procesin e vendimmarrjes në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ne përdorim teknologjinë e informacionit për të avancuar këto përpjekje, duke mbështetur përdorimin e mjeteve digjitale për të demokratizuar dhe modernizuar shoqërinë tonë.

Puna jonë kontribuon në krijimin e praktikave të mira të qeverisjes në institucionet publike, si në nivel qendror ashtu edhe lokal, duke forcuar sundimin e ligjit, zhvilluar partitë politike dhe mbështetur procese zgjedhore të lira dhe të ndershme. Përmes hulumtimeve, dialogut publik dhe edukimit, iniciativat tona synojnë të zvogëlojnë hendekun midis vendimmarrësve dhe qytetarëve. Mbi të gjitha, ne mbështesim vlerat dhe praktikat demokratike, duke fuqizuar zërat e qytetarëve të Kosovës dhe duke promovuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse.

Gjatë vitit 2025, D+ ka vazhduar të punojë në ndërtimin e një kulture demokratike përmes aktiviteteve të shumta të cilat kanë pasur synim ndikimin në vendimmarrje, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikbërje si dhe përmirësimin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të kryera gjatë vitit 2025 nga D+ dhe ndikimin që ato kanë pasur në përmbushjen e misionit tonë.

Vizioni

Qeverisje dhe shoqëri ku kultura dhe vlerat demokratike janë normë.

Misioni

D+ angazhohet për zhvillimin e një shoqërie demokratike, përmes ndikimit në vendimmarrje dhe fuqizimit të pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave publike.

Programet

Qeverisje e Mirë

Sundimi i Ligjit

Partitë Politike dhe Zgjedhjet

1. Fuqizimi i të rinjve për integritet, përvojë dhe transformim digjital

1.1 Shkolla për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit

Gjatë 2025, në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) dhe me përkrahjen e Fondit të Kanadasë për Iniciativa Lokale (CFLI), D+ organizoi Shkollën për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit, një nismë e parë e këtij lloji në Kosovë.

Shkolla tre-ditore trajnoi 25 pjesëmarrës në temat e integritetit, etikës, transparencës dhe parandalimit të korrupsionit, për t'u bërë zëra të fortë të integritetit dhe për të kontribuar si qytetarë aktivë dhe liderë të ardhshëm në shërbimin publik. Gjatë saj u mbajtën shtatë ligjërata cilësore nga përfaqësues të APK-së, ekspertë të shoqërisë civile dhe profesionistë të mediave, duke ofruar perspektiva praktike dhe të shumëanshme. Testimet pas ligjëratave, treguan rezultate shumë të larta të të nxënit, me një mesatare prej 91%.

Testimet pas ligjëratave treguan rezultate shumë të larta të të nxënit, me një mesatare prej 91%.





Shkolla ka kontribuar ndjeshëm në ndërtimin e kapaciteteve të një brezi të ri profesionistësh të përkushtuar ndaj integritetit dhe parandalimit të korrupsionit në Kosovë.

Shkolla u përmbyll duke shënuar kulmin e një angazhimi intensiv në fushën e integritetit dhe parandalimit të korrupsionit. Katër pjesëmarrësve iu dha mundësia të vazhdojnë angazhimin profesional përmes një praktike tre-mujore në APK. Mundësia për të kontribuar brenda një institucioni kyç në parandalimin e korrupsionit dëshmon ndikimin e drejtpërdrejtë të D+ në krijimin e urave ndërmjet edukimit dhe angazhimit praktik në sektorin publik.

Në tërësi, shkolla ka kontribuar ndjeshëm në ndërtimin e kapaciteteve të një brezi të ri profesionistësh të përkushtuar ndaj integritetit dhe parandalimit të korrupsionit në Kosovë. D+ vazhdon angazhimin në fuqizimin e të rinjve për integritet dhe qeverisje të mirë, duke bashkëpunuar me APK në përgatitjen e edicionit të dytë të shkollës.

1.2 Programi i 9-të i Punës Praktike

Programi i 9-të i Punës Praktike, i zbatuar nga D+ në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë, vazhdoi të shërbejë si një ndër mekanizmat më të rëndësishëm për fuqizimin profesional të të rinjve dhe rritjen e përfshirjes së tyre në institucionet lokale.


Në bashkëpunim me qendrat rajonale të OSBE-së, 15 praktikantë u sistemuan në 12 institucione dhe organizata lokale në pesë rajone të Kosovës, përfshirë komuna, organizata të shoqërisë civile dhe qendra rinore.

Programi përfshiu dy trajnime me tema si:

- Funksionimi i institucioneve komunale, hartimi i politikave publike dhe komunikimi zyrtar;
- Përgatitja e CV-ve, zhvillimi i kampanjave për rrjete sociale dhe përfshirja e të rinjve në qeverisjen lokale.

Këtë vit, programi u pasurua me një komponent të ri mentorimi, duke forcuar më tej lidhjen mes ish-praktikantëve dhe gjeneratave të reja. Pesë ish-praktikantë, tashmë të angazhuar në institucione publike dhe organizata të shoqërisë civile, ofruan mbështetje të drejtpërdrejtë për pesë të rinj nga gjenerata e kaluar, me nga 16 orë mentorim individual për secilin. Fokus i këtij angazhimi ishte orientimi në tregun e punës, përmirësimi i CV-ve, përgatitja për aplikime dhe konsolidimi i planit të zhvillimit profesional.

Në bashkëpunim me qendrat rajonale të OSBE-së, 15 praktikantë u sistemuan në 12 institucione dhe organizata lokale e rinore në pesë rajone të Kosovës.





Vlerësimi me 56 ish-praktikantë konfirmoi ndikimin e qëndrueshëm të programit: 95% raportuan rritje të vetëbesimit gjatë aplikimeve për punë, 89% theksuan përmirësim të aftësive bazë profesionale, ndërsa 94% do ta rekomandonin programin tek të tjerët.

Krahas këtij ndikimi, D+ promovoi programin edhe përmes dy sesioneve informuese të hapura në IBCM dhe Kolegjin AAB, ku 129 studentë patën mundësinë të dëgjojnë drejtpërdrejt përvojat profesionale të ish-praktikantëve të suksesshëm.

Këto aktivitete kontribuan në rritjen e dukshmërisë së programit dhe në frymëzimin e të rinjve për t'u përfshirë në nisma që mbështesin zhvillimin e tyre profesional.



1.3 Kampi rinor mbi inteligjencën artificiale dhe demokracinë



Në bashkëpunim me Konrad-Adenauer-Stiftung Kosovë (KAS Kosovo), D+ organizoi Kampin Rinor mbi Inteligjencën Artificiale dhe Demokracinë, duke krijuar një hapësirë unike për reflektim kritik mbi ndërthurjen e teknologjisë me proceset demokratike. Të rinjtë nga komuna të ndryshme të Kosovës u mbledhën për një fundjavë intensive diskutimesh dhe shkëmbimi idesh, duke analizuar transformimin e demokracisë nga hapësira tradicionale qytetare në atë digjitale, rolin e rrjeteve sociale dhe sfidën e përhapjes së dezinformimit.

Gjatë sesioneve tematike, pjesëmarrësit diskutuan ndikimin e algoritmeve dhe komunikimit digjital në përfshirjen qytetare, si dhe rrezikun e “autoritarizmit të ri”, ku manipulimi emocional dhe amplifikimi i përmbajtjeve polarizuese mund të minojnë qëndrueshmërinë demokratike. Përmes dialogut të hapur dhe analizës së rasteve konkrete, D+ kontribuoi në fuqizimin e të rinjve me njohuri dhe mjete për të kuptuar më thellë ndikimin e inteligjencës artificiale në demokraci, duke nxitur një brez më të ndërgjegjshëm dhe aktiv në epokën digjitale.

2. Mbështetja e Programit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë

Në shkurt të 2025, D+ filloi mbështetjen e Programit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K) – Faza 2, në kuadër të Kontratës Nr. IWRMK2-CPS-2025-002, e financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Gjatë kësaj periudhe, D+ hartoi dhe lansoi Skemën e Granteve për Organizatat e Shoqërisë Civile për Fazën 2, e cila rezultoi me 34 aplikime të pranueshme nga OShC-të nga më shumë se 20 komuna në Kosovë.

Pas vlerësimit administrativ dhe teknik, u përzgjedhën gjashtë grante, me buxhete individuale të projekteve që variojnë nga rreth 28,900 EUR deri në 49,955 EUR, duke mbështetur iniciativa të fokusuar në uljen e ndotjes së ujërave, përdorimin e qëndrueshëm të ujit, angazhimin e komunitetit dhe zgjidhje inovative për menaxhimin e resurseve ujore.



D+ organizoi një punëtori për fillimin e implementimit me 20 pjesëmarrës dhe realizoi nëntë sesione të synuara për ngritje të kapaciteteve.



Për të mbështetur zbatimin efektiv, D+ organizoi një punëtori për fillimin e implementimit me 20 pjesëmarrës dhe realizoi nëntë sesione të synuara për ngritje të kapaciteteve, të fokusuar në prokurim, avokim, menaxhim financiar dhe komunikim, bazuar në vlerësimet individuale të nevojave të secilit grantmarrës.

Paralelisht, D+ mbështeti institucionalizimin e mekanizmave të qeverisjes pjesëmarrëse në menaxhim të ujërave. U hartua një Udhëzues gjithëpërfshirës për Mekanizmin e Pjesëmarrjes Shumëpalëshe (MSPM), i cili u miratua zyrtarisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në dhjetor 2025, duke vendosur procedura të standardizuara për përfshirjen e palëve të interesit në konsultimet për Planet e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore.



Gjithashtu, D+ identifikoi të gjithë aktorët relevantë në katër pellgjet lumore – Drini i Bardhë, Lepenci, Morava e Binçës dhe Ibri – duke siguruar përfaqësim nga shoqëria civile, komunat, institucionet publike, akademika dhe sektori privat. Veçanërisht, u themelua për herë të parë mekanizmi i palëve të interesit për pellgun e Drinit të Bardhë, duke adresuar një boshllëk të mëparshëm institucional. Këto ndërhyrje fuqizuan koordinimin ndërmjet veprimeve lokale të udhëhequra nga OShC-të dhe proceseve kombëtare të qeverisjes së ujërave, duke vendosur bazat për një menaxhim gjithëpërfshirës të burimeve ujore në Kosovë, të qëndrueshëm dhe të bazuar në të dhëna.



U themelua për herë të parë mekanizmi i palëve të interesit për pellgun e Drinit të Bardhë, duke adresuar një boshllëk të mëparshëm institucional.



3. Monitorimi i prokurimit publik

3.1 Monitorimi i prokurimit publik në nivel ministror dhe lokal

Gjatë 2025, D+ ka vazhduar angazhimin e saj në monitorimin e prokurimit publik në nivel qendror dhe lokal, me fokus në transparencë, llogaridhënie dhe respektim të kornizës ligjore në fuqi. Përmes monitorimit të drejtpërdrejtë të procedurave të prokurimit, analizës së kontratave specifike, raportimit publik dhe avokimit institucional, D+ ka kontribuar në identifikimin e parregullsive, adresimin e praktikave problematike dhe forcimin e debatit publik mbi qeverisjen e mirë në prokurim publik.

Në kuadër të aktiviteteve monitoruese, D+ ka monitoruar rreth 10 procedura të prokurimit publik të natyrave të ndryshme, të zhvilluara në nivel qendror dhe lokal, me fokus në tre ministri dhe tre komuna, duke mbuluar të gjitha fazat kryesore të procesit, nga planifikimi dhe hartimi i dosjes së tenderit, te vlerësimi i ofertave, nënshkrimi dhe zbatimi i kontratave.

Tetë gjetjet e këtyre monitorimeve janë reflektuar në raportin [Integriteti në Prokurim Publik: Sfidat dhe parregullsitë në nivel qendror dhe lokal](#) dhe përfshijnë, ndër të tjera:

- Vendosijen e kërkesave diskriminuese dhe favorizuese në dosjet e tenderit;
- Anulime të kundërligjshme të procedurave të prokurimit;
- Hartim të specifikimeve teknike që i referohen drejtpërdrejt një produkti ose prodhuesi të caktuar;
- Përdorim të pajustificuar të procedurës së negociuar, në kundërshtim me parimet e konkurrencës dhe transparencës;
- Ekzekutim të pagesave dhe/ose avanseve në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kontraktuale, duke rritur rrezikun për keqpërdorim të fondeve publike.



Në bazë të gjetjeve të identifikuara, D+ ka adresuar tetë rekomandime konkrete për institucionet publike, me qëllim të përmirësimit të praktikave ekzistuese:

- Rritja e transparencës dhe kontrollit financiar;
- Garantimi i konkurrencës së ndershme në procedurat e prokurimit;
- Zbatim konsistent i kriterëve dhe procedurave ligjore;
- Nxitja e pjesëmarrjes dhe profesionalizmit në prokurim;
- Zbatim i drejtë dhe i justifikuar i procedurave të prokurimit.

3.2 Monitorimi dhe analizimi i marrëveshjeve për shërbime të veçanta



Raporti përfshin gjithashtu 13 rekomandime, të strukturuar në pesë (5) fusha tematike, të cilat synojnë adresimin e mangësive kryesore të identifikuara në përdorimin e MShV-ve. Rekomandimet fokusohen në përmirësimin e planifikimit të burimeve njerëzore, qartësimin e kornizës ligjore, forcimin e procedurave konkurruese dhe kritereve profesionale të përzgjedhjes, parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe rritjen e transparencës dhe mbikëqyrjes institucionale, me qëllim rikthimin e MShV-ve në funksionin e tyre ligjor.

D+ do të vazhdojë të monitorojë përdorimin e MShV-ve në institucionet publike, duke identifikuar dhe raportuar raste të mundshme të konfliktit të interesit, angazhimeve të përsëritura të të njëjtëve individë dhe shkeljeve të procedurave të rregullta të përzgjedhjes. Ky angazhim synon të forcojë transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin efikas të burimeve njerëzore dhe financiare në administratën publike.

D+ ka vazhduar monitorimin e Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV) në institucionet publike, duke publikuar raportin e katërt me radhë mbi këtë çështje, “Shërbime ‘të veçanta’ për punë të zakonshme: si po zbehet qëllimi i MShV-ve në Kosovë”.

Në kuadër të këtij monitorimi janë identifikuar 95 kontrata për MShV, ndërsa për analizë janë përzgjedhur shtatë (7) institucione publike, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, si dhe komunat e Prishtinës, Vushtrrisë, Klinës dhe Kamenicës.

Gjetjet e raportit tregojnë se MShV-të vazhdojnë të përdoren për punë administrative, menaxhim projektesh dhe shërbime juridike me karakter të përhershëm, duke reflektuar dobësi në planifikimin e burimeve njerëzore. Njëkohësisht, janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, angazhime të përsëritura të të njëjtëve persona, shmangie të procedurave të rregullta të rekrutimit, si dhe përdorim i papërshtatshëm i procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes, në dëm të konkurrencës, meritës dhe profesionalizmit.



3.3 Reagime mbi keqpërdorimin e procedurave të prokurimit

Përveç monitorimit të drejtpërdrejtë dhe reflektimit të gjetjeve në raportin tematik, D+ ka ndërmarrë veprime konkrete, publike dhe jo publike, me qëllim të forcimit të mbikëqyrjes së shpenzimit të parasë publike dhe adresimit institucional të parregullsive të identifikuara. Në këtë kuadër, D+ u ka adresuar autoriteteve kontraktuese reagime të drejtpërdrejta lidhur me raste konkrete të dyshuara të shkeljeve në prokurim publik, si në vijim:

➤ Reagim drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës për përjashtim nga procesi i vlerësimit të operatorit ekonomik i cili kishte ofertuar përmes një biznesi të shuar dhe i dënuar për mashtrim në prokurim publik, duke ngritur shqetësime serioze mbi respektimin e kriterëve ligjore dhe integritetin e procesit të vlerësimit.

➤ Reagim drejtuar Komunës së Shtimes, në një rast ku dyshohet se operatori ekonomik ku ekziston dyshimi i bazuar se operatori ekonomik ka qenë i përfshirë në hartimin e dokumentacionit të tenderit dhe më pas është rekomanduar për dhënie të kontratës për të njëjtin tender, çka përbën konflikt interesi dhe cenon parimet e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë.

➤ Dyshime për konflikt interesi dhe cenim të konkurrencës së lirë nga operatorët Geo-Map/Pro & Co Group;

➤ Dyshime për paraqitje të dokumentacionit të falsifikuar në ofertë nga Archi Time Sh.P.K.;

➤ Dyshime për përgatitje të dokumentacionit të tenderit nga operatori ekonomik pranë Komunës së Shtimes për procedurën “Mirëmbajtja e infrastrukturës”.

Ndërsa, rastet e deponuara pranë APK përfshijnë dyshime për konflikt interesi, të evidentuara si në përdorimin e MShV-ve, ashtu edhe në kontrata të tjera të lidhura me procedurat e prokurimit publik. Disa nga këto raste përfshijnë:

➤ Dyshime për konflikt interesi në kontraktimin e ish-udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit nga Ministria e Ekonomisë, vetëm 76 ditë pas pensionimit, përmes kontratës për marrëveshje për shërbimeve të veçanta. APK ka konstatuar konfliktin e interesit duke kërkuar anulimin e kontratës dhe njëkohësisht ka iniciuar procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente (Vendimi Nr. 1631/25, 15.08.2025).

3.4 Inicimi i procedurave për llogaridhënie institucionale në institucionet e drejtësisë

Bazuar në gjetjet e monitorimit dhe analizën e dokumentacionit përkatës D+ ka ndërmarrë veprime konkrete për të kontribuar në forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe sundimit të ligjit në fushën e prokurimit publik. Në këtë kuadër, D+ ka dorëzuar tri raste të veçanta për shqyrtim në Prokurori dhe ka parashtruar shtatë kërkesa për vlerësimin e konfliktit të interesit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK).

Rastet e dorëzuara në Prokurori janë të lidhura me dyshime për konflikt interesi, cenim të konkurrencës së lirë dhe paraqitje të dokumentacionit të dyshimtë nga operatorët ekonomikë. Konkretisht, rastet përfshijnë:

➤ APK ka konstatuar konflikt interesi në rastin e zyrtarit përgjegjës të prokurimit në Komunën e Kacanikut, të paraqitur nga D+. Zyrtari, në cilësinë e menaxherit të prokurimit, ka nënshkruar kontratë publike me operatorin ekonomik me të cilin ai kishte marrëdhënie afariste. APK ka kërkuar anulimin e kontratës, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj zyrtarit dhe ka deponuar rastin në prokurori.

Përveç këtyre rasteve, D+ ka paraqitur pranë këtij institucioni edhe disa raste të tjera që lidhen me dyshime për konflikt interesi në institucione të ndryshme, përfshirë Komunën e Vushtrrisë, Komunën e Prishtinës, Ministrinë e Shëndetësisë, Komunën e Glllogocit dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).

3.5 Publikimi i artikujve hulumtues

Në kuadër të përpjekjeve për të promovuar transparencën dhe me qëllim të forcimit të debatit publik të bazuar në fakte në fushën e prokurimit publik, D+ ka mbështetur angazhimin e gazetarëve dhe hulumtuesve në prokurim publik për të trajtuar tema me interes të lartë publik. Përmes këtyre hulumtimeve, janë adresuar raste konkrete dhe praktika të reja institucionale, me qëllim të analizimit të përputhshmërisë së tyre me kornizën ligjore në fuqi, si dhe të evidentimit të sfidave që ndikojnë në menaxhimin e fondeve publike. Artikujt hulumtues të realizuar dhe të publikuar gjatë vitit 2025 përfshijnë:

[Dyshime për favorizim të një kompanie nga Ministria e Shëndetësisë në tenderin për Institutin Special në Shtime](#)

Ky artikull trajton mënyrën se si procedurat e prokurimit publik mund të ndikojnë në realizimin e projekteve infrastrukturore shëndetësore. Pavarësisht rëndësisë së projektit për përmirësimin e kushteve të kujdesit institucional, tenderi ka ngjallur dyshime për favorizim dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërprerje të procesit për shkak të ankesave dhe vonesa në shqyrtimin nga organet përkatëse. Rasti tregon nevojën për transparencë, respektim të standardeve ligjore dhe përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje, për të garantuar menaxhim efektiv të fondeve publike dhe zbatimin e projekteve në përputhje me ligjin.

[Skandali i kontratës së dyfishtë në Spitalin e Gjilanit: Ligji i shkelur dhe institucionet që heshtin](#)

Ky artikull trajton mënyrën se si mosrespektimi i Ligjit për Prokurimin Publik dhe mungesa e përgjegjësisë institucionale ndikojnë në menaxhimin e fondeve publike. Spitali i Gjilanit lidhi në nëntor 2023 një kontratë të re për shërbime pastrimi me kompaninë “Mburoya” Sh.P.K., pavarësisht se kontrata ekzistuese me “Aroma Plus” ishte ende në fuqi. Kjo u realizua përmes një procedure të negociuar pa publikim, e cila nuk plotësonte kushtet e jashtëzakonshme të parashikuara nga ligji. Rekomandimi i KRPP-së për moslidhjen e kontratës u injorua, ndërsa OShP e shfuqizoi më pas kontratën, duke konstatuar shkelje të qarta ligjore dhe procedurale. Rasti tregon dështimin e autoritetit kontraktues dhe të organeve mbikëqyrëse për të garantuar transparencë, trajtim të barabartë të operatorëve dhe përdorim efektiv të fondeve publike, duke lënë hapësirë për keqpërdorime dhe procese gjyqësore të zgjatura.

Financuar nga
Bashkimi Evropian

Dyshime për favorizim të një kompanie nga Ministria e Shëndetësisë në tenderin për Institutin Special në Shtime

Mbi gjashtë milionë euro do të kushtojë ndërtimi i objektit të Institutit Special në Shtime. Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka përzgjedhur kompaninë, oferta e së cilës ishte ndër më të shtrenjtat në këtë tender. Procesi është shoqëruar me dyshime për shkelje të procedurave të prokurimit dhe favorizim të kompanisë.

Artikull
Majlinda Ibrahim



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Skandali i kontratës së dyfishtë në Spitalin e Gjilanit: Ligji i shkelur dhe institucionet që heshtin

Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit ka nënshkruar një kontratë të re për shërbime pastrimi, ndërkohë që kishte një kontratë ekzistuese në fuqi, një veprim në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). Përkundër shkeljeve të qarta, asnjë institucion nuk ka marrë masa konkrete deri më sot.

Artikull
Dardan Gashi



Praktika e re e anulimit të kontratave pas shpalljes së fituesit: një shqetësim në rritje në prokurim publik

Ky artikull vë në pah pasojat e mungesës së përgjegjësisë institucionale në menaxhimin e procedurave të prokurimit publik nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet vartëse të saj. Gjatë viteve 2020–2025, disa kontrata të shpallura fituese nga AK-të, përfshirë Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për Menaxhim Emergjent, janë anuluar pas publikimit të fituesit, për shkak të mosnënshkrimit të kontratës nga ministri. Kjo praktikë ka sjellë vonesa të gjata në zbatimin e projekteve, rritje të kostove, pasiguri juridike për operatorët ekonomikë dhe cenim të transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Rasti thekson nevojën për respektim rigoroz të Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloreve përkatëse, si dhe për vendimmarrje të dokumentuar dhe transparente nga autoritetet kontraktuese.

Në vijim të angazhimeve për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në prokurimin publik, artikujt hulumtues të mbështetur nga D+ gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në rritjen e informimit publik mbi çështje me interes të lartë. Përmes trajtimit të rasteve konkrete, këto hulumtime kanë evidentuar sfida në zbatimin e kornizës ligjore dhe nevojën për forcimin e mbikëqyrjes institucionale.

3.6 Analiza e proceseve dhe sfidave në prokurimin publik

Gjatë vitit raportues, D+ ka vazhduar monitorimin sistematik të procedurave të prokurimit publik, me qëllim forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në shpenzimin e parasë publike. Ky angazhim është pjesë e përkushtimit afatgjatë të organizatës për të adresuar mangësitë strukturore në sistemin e prokurimit publik dhe për të kontribuar në përmirësimin e politikave dhe praktikave institucionale.

Në bazë të monitorimit, D+ ka hartuar pesë (5) analiza tematike të shkurtra, të cilat trajtojnë raste konkrete dhe problematika sistematike që lidhen me korrupsionin, keqpërdorimin e procedurave, mungesën e ndëshkueshmërisë dhe aspektet gjinore në prokurim publik. Analizat ofrojnë gjetje të bazuara në evidencë dhe rekomandime të qarta për institucionet përgjegjëse, me synim përmirësimin e zbatimit të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) dhe forcimin e mekanizmave mbikëqyrës.

Institucionet e trajtuara në këto analiza përfshijnë, ndër të tjera, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kuvendin e Kosovës, si dhe disa komuna të Kosovës.



Në total, janë dhënë njëzet e gjashtë (26) rekomandime konkrete për autoritetet kontraktuese dhe institucionet mbikëqyrëse. Këto rekomandime janë publikuar, janë ndarë me media dhe janë adresuar edhe përmes takimeve avokuese me përfaqësues institucionale.

Analizat e publikuara

Pesë analizat tematike të publikuara gjatë vitit janë:

- Shkeljet ligjore: Kontrata për pastrim dhe greva e punëtorëve në Kuvendin e Kosovës
- Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në Kosovë: Analizë e situatës dhe problemeve në zbatim
- Shqyrtimi i ankesave dhe mjetet juridike në prokurimin publik në Kosovë
- Prokurimi i Përgjegjshëm Gjikor në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë për Zbatim Efektiv
- A po lihen punët për fund? Çfarë ndodh me investimet kapitale kur afrohen zgjedhjet lokale?

Përmbledhje e gjetjeve kryesore sipas analizave

Shkeljet ligjore në kontratën e pastrimit në Kuvendin e Kosovës

Analiza tregon se Kuvendi i Kosovës kishte përgjegjësi direkte në krijimin e situatës emergjente, të cilën më pas e përdori për të justifikuar lidhjen e një kontrate njëburimore. Gjetjet nxjerrin në pah shkelje në kushtet e punës së punëtorëve, përfshirë mungesën e pagesës për orë shtesë, si dhe shmangien e përgjegjësisë institucionale gjatë grevës së punëtorëve.



Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në Kosovë: Analizë e situatës dhe problemeve në zbatim

Analiza e evidenton se përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë mbetet problematike, jo për nga vlera apo numri i kontratave, por për shkak të arsyeve të pajustificuara ligjërisht për përdorimin e saj. Në disa raste, kjo procedurë është përdorur si pasojë e mungesës së planifikimit të duhur të prokurimit, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe standardet e Bashkimit Evropian.



Shqyrtimi i ankesave dhe mjetet juridike në prokurimin publik

Analiza identifikon sfida serioze në funksionimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, veçanërisht mungesën e kapaciteteve të plota vendimmarrëse dhe vonesat në trajtimin e ankesave. Këto mangësi ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e sistemit të mbrojtjes juridike në prokurim publik dhe në besimin e operatorëve ekonomikë.





Prokurimi i Përgjegjshëm Gjnjor në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë për Zbatim Efektiv

Gjetyt tregojnë se, pavarësisht kornizës ligjore ekzistuese, integrimi i perspektivës gjnjore në prokurim publik mbetet kryesisht formal. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë, kapacitetet e kufizuara institucionale dhe mungesa e mekanizmave të monitorimit pengojnë zbatimin efektiv të prokurimit të përgjegjshëm gjnjor.

3.7 Monitorimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)

D+ ka publikuar raportin e monitorimit mbi vendimet dhe praktikën e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për periudhën janar–dhjetor 2024 “Sfidat e OSHP-së zvarritin aktivitetet e prokurimit”. Raporti ofron një analizë të detajuar të sfidave kryesore që ndikojnë në funksionimin e OSHP-së dhe vlerëson pasojat e tyre në efikasitetin dhe mbarëvajtjen e proceseve të prokurimit publik.



A po lihen punët për fund: Çfarë ndodh me investimet kapitale kur afrohen zgjedhjet lokale?

Analiza tregon se viti zgjedhor nuk shoqërohet domosdoshmërisht me rritje të investimeve kapitale, por me përqendrim të buxhetit në një numër më të kufizuar projektesh me vlerë më të lartë. Dallimet ndërmjet komunave, veçanërisht kur investimet maten për kokë banori, ngrenë shqetësime lidhur me planifikimin dhe prioritetet e shpenzimeve publike.

Përmes këtij raporti, D+ ka identifikuar dhe trajtuar gjashtë sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet OSHP si dhe ka propozuar 10 rekomandime konkrete me qëllim të forcimit të transparencës, rritjes së efikasitetit dhe përmirësimit të efektivitetit të funksionimit të këtij institucioni në trajtimin e ankesave dhe në mbarëvajtjen e përgjithshme të proceseve të prokurimit publik.

Ndër rekomandimet kryesore të dala nga raporti janë përfundimi i kornizës së brendshme rregullative të OShP-së, forcimi i transparencës përmes përmirësimit të qasjes në të dhëna dhe publikimit të plotë të vendimeve, si dhe rritja e efikasitetit në trajtimin e ankesave përmes praktikave më të qarta dhe të unifikuara vendimmarrëse. Rekomandimet synojnë gjithashtu fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e llogaridhënies në funksionimin e këtij institucioni.

Gjatë këtij viti, D+ i ka kushtuar vëmendje të veçantë respektimit të vendimeve për diskualifikimin e operatorëve ekonomikë, veçanërisht në rastet kur subjektet e përfshira, pavarësisht se ndodheshin në listën e zezë, kanë vazhduar të përfitojnë kontrata publike. Në këtë kontekst, D+ ka evidentuar tri raste të tilla dhe ka parashtruar kërkesa për anulimin e kontratave pranë autoriteteve kontraktuese përkatëse. Si rezultat i ndërhyrjes së D+, në një nga këto raste është ndërmarrë masa e shkëputjes së kontratës.

Përveç këtyre angazhimeve, D+ ka vijuar në mënyrë të qëndrueshme monitorimin e drejtpërdrejtë përmes ndjekjes së seancave dëgjimore. Gjetjet nga monitorimi i realizuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2025 dhe pjesës së parë të vitit 2026 do të përmbliidhen në një raport të detajuar, i cili planifikohet të publikohet në mesin e vitit të ardhshëm.

Njëkohësisht, D+ ka mbështetur OShP-në në procesin e hartimit të planit të performancës për vitin 2025. Përmes angazhimit aktiv në grupin punues të këtij institucioni, është hartuar një plan gjithëpërfshirës i performancës, i strukturuar mbi objektiva strategjike, indikatorë të qartë dhe aktivitete të matshme, me synimin për të rritur më tej efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien në funksionimin e OShP-së.

3.8 Avokimi, monitorimi dhe kontributi i D+ në hartimin e politikave publike

D+ ka zhvilluar një sërë takimesh avokuese me përfaqësues të ministrive, komunave, deputetë të Kuvendit të Kosovës, organizata të shoqërisë civile dhe akterë të tjerë relevant, me qëllim diskutimin dhe adresimin e gjetjeve të dala nga raportet e D+ në fushën e prokurimit publik, si dhe propozimin e rekomandimeve konkrete për përmirësime në nivel politikash.



Në kuadër të këtij angazhimi, D+ ka bashkëpunuar dhe ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me institucionet kyçe të sistemit të prokurimit publik, përfshirë autoritetet kontraktuese të përfshira në monitorim, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), OShP, si dhe institucione të tjera relevante.

Po ashtu, kemi ndjekur dhe monitoruar nga afër procedurën e tenderimit për hartimin e planit të fizibilitetit për ndërtimin e objektit të Presidencës së Republikës së Kosovës, që nga faza fillestare e procedurës deri në dhënien e kontratës.

Krahas kësaj, D+ ka dhënë kontribut substancial në proceset e konsultimit publik për dokumente strategjike dhe nënligjore, përfshirë Planin e Veprimit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike dhe draft-rregulloren për prokurim publik, duke paraqitur vërejtje të argumentuara dhe sugjerime profesionale me synim avancimin e kuadrit rregullativ dhe forcimin e integritetit institucional në fushën e prokurimit publik.



3.9 Përfshirja në formësimin e politikave publike

Gjatë vitit 2025, D+ ka ofruar gjithsej 96 komente në kuadër të 10 proceseve të konsultimit publik për draft-politika në nivel qendror dhe lokal, me fokus në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Rekomandimet e D+ janë fokusuar në transparencë institucionale, qasje në informata publike, mbrojtje të të dhënave personale dhe forcim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Të gjitha komentet janë dorëzuar përmes Platformës së Konsultimeve Publike dhe dërguar tek institucionet përkatëse. Deri në hartimin e këtij raporti, institucionet ende nuk kanë publikuar raportet përfundimtare të konsultimit publik.

Përmes këtij angazhimi, D+ vazhdon të kontribuojë në ndërtimin e proceseve më transparente dhe më të hapura të hartimit të politikave publike.

Komente janë dhënë për draft-politika në nivel lokal, kryesisht për planet komunale të transparencës



Komente janë dhënë për draft-politika në nivel qendror, të iniciuara nga ministri dhe agjenci përgjegjëse

4. Fuqizimi i Qytetarëve dhe Reforma Administrative në Kosovë



Gjatë 2025, D+ ka luajtur rol kyç në promovimin e procedurave të drejta dhe efikase administrative për qytetarët dhe bizneset në Kosovë. Përmes analizave të politikave, advokimit publik dhe mbështetjes direkte ligjore, D+ ka kontribuar në rritjen e llogaridhënies institucionale, thjeshtimin e procedurave dhe fuqizimin e qytetarëve për të kërkuar të drejtat e tyre.

Në kuadër të mbështetjes së Programit për Administratë më të Mirë dhe Reforma të Politikave (ABPR 2022–2027), D+ realizoi tre (3) analiza të detajuara të shërbimeve publike në tetë institucione, duke ofruar 84 rekomandime konkrete për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, reduktimin e barrës administrative dhe avancimin e digjitalizimit. Për të rritur transparencën dhe përfshirjen publike,

D+ prodhoi infografika, video të animuara, organizoi debate televizive dhe konferenca rajonale, si dhe lehtësoi takime ndërinstucionale që forcuan koordinimin dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile.

Në avancimin e të drejtës së qytetarëve për kompensim, D+ realizoi analizë të veçantë të legjislacionit për kompensim dhe publikoi biringje të shpejta mbi raste gjyqësore, duke nxitur qytetarët të kërkojnë të drejtat e tyre. Përmes angazhimit të tre zyrtarëve ligjorë në degët e FLAA në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjakovë, D+ ofroi asistencë direkte për 751 qytetarë në çështje administrative dhe kompensimi. Aktivitetet ndërgjegjësuere dhe takimet advokuese me gjyqtarë, deputetë, zyrtarë qeveritarë dhe Avokatin e Popullit kontribuan në përmirësimin e praktikave institucionale dhe rritjen e vetëdijes për të drejtën në kompensim.

Në tërësi, kontributi i D+ ka ndikuar në forcimin e koordinimit ndërinstucional, përmirësimin e qasjes në shërbime publike, avancimin e digjitalizimit dhe fuqizimin e qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre, duke mbështetur zbatimin e reformave në administratën publike të Kosovës.



Sa qytetarë/e kanë përfituar ndihmë juridike falas për kompensim nga autoritetet publike, përmes zyrtarëve ligjorë të Democracy Plus?

Tetor 2024 - Maj 2025



751 qytetarë/e



342
(45.5%)
Gra



409
(54.5%)
Burra

5. Fuqizimi i grave fermere

Në kuadër të angazhimit për politika publike më gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme gjinore, D+ organizoi takime me gra fermere në Rahovec dhe Podujevë për të adresuar sfidat që ato përjetojnë si pasojë e ndryshimeve klimatike. Përmes bashkëbisedimeve të hapura, gratë fermere ngritën shqetësime konkrete lidhur me pasojat e thatësirave dhe përmbytjeve në rendimentin bujqësor, vështirësitë në qasjen në subvencione, mungesën e informacionit për thirrjet publike dhe nevojën për mbështetje teknike gjatë aplikimit.

U theksua gjithashtu barra e punës së papaguar brenda ekonomive familjare, e cila ndikon drejtpërdrejt në mundësitë e tyre për zhvillim profesional dhe ekonomik.

Tryeza hapi rrugë për rekomandime konkrete për politika bujqësore dhe klimatike më të përgjegjshme gjinore.





Këto diskutime kulmuan me tryezën “Gratë në Bujqësi përballë Ndryshimeve Klimatike: Sfidat dhe Mundësitë në Rahovec dhe Podujevë”, ku D+ prezantoi gjetjet e hulumtimit dhe nxiti dialog ndërmjet institucioneve lokale, shoqërisë civile dhe ekspertëve të fushës.

Tryeza hapi rrugë për rekomandime konkrete drejt politikave bujqësore dhe klimatike më të përgjegjshme gjinore, përfshirë buxhetimin gjinor dhe forcimin e mbështetjes institucionale për gratë fermere.

Aktiviteti u realizua me mbështetjen e Rrjetit të Grave të Kosovës, përmes Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetimit Gjinor II (GBWN II), financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Suedia, duke forcuar kështu përpjekjet për një bujqësi më të qëndrueshme dhe më të barabartë në Kosovë.





6. Monitorimi i projekteve publike me Auditimin Social

Gjatë vitit 2025, D+ ka zbatuar me sukses projektin e Auditimit Social, duke fuqizuar qytetarët për të monitoruar dhe vlerësuar mënyrën se si shpenzohen fondet publike në nivel lokal. Ky proces synon rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e shërbimeve publike në disa komuna të Kosovës.

D+ ka angazhuar grupe qytetarësh në Lipjan dhe Mamushë, të cilët kanë monitoruar projekte të rëndësishme komunale, si “Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së, Krojmir”, “Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturofc dhe Ribar i Madh”, “Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi” dhe “Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)”, si dhe monitorimi i projektit “Gjeneratorë dhe paisje elektrike për pastrimin e dyshemeve - për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)”. Përmes kësaj qasjeje, D+ forcoi pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e mbikëqyrjes dhe kontribuoi në një qeverisje lokale më të përgjegjshme dhe më transparente.

Gjatë këtij procesi, qytetarët kanë marrë pjesë aktive në trajnime, takime me institucione dhe vizita në terren, duke analizuar progresin dhe cilësinë e këtyre investimeve.



Raportet e përgatitura (Raporti i ekipit të auditimit social në Lipjan dhe Raporti i ekipit të auditimit social në Mamushë) nga grupet e Auditimit Social kanë ofruar gjetje konkrete dhe rekomandime praktike, të cilat synojnë përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike dhe adresimin e problemeve të evidentuara.

Qytetarët jo vetëm që kanë monitoruar investimet publike, por edhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe forcimin e llogaridhënies institucionale. Këto raporte janë prezantuar në takime me kryetarët dhe nënkryetarët e komunave, ku janë diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e qytetarëve, si dhe janë marrë komente dhe sugjerime nga ana e tyre.

Auditimi Social po dëshmon se qytetarët, kur janë të informuar dhe të përfshirë, mund të jenë një forcë kyçe për ndryshime pozitive në komunitetin e tyre.

Përkushtimi i D+ për të avancuar transparencën dhe qeverisjen e mirë do të vazhdojë, duke ndihmuar në krijimin e një administrate më të hapur dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve.



7. Përprojekjet për parandalimin e përhapjes së lajmeve të rreme


7.1 Informimi dhe orientimi ndaj lajmeve të rreme në internet

Përmes projektit INFO, të mbështetur nga SEE Check Network, D+ mori rol udhëheqës në forcimin e rezistencës së të rinjve në Kosovë ndaj dezinformimit. Duke aplikuar një qasje të integruar dhe strategjike, D+ kombinoi mjete digjitale inovative, trajnime fizike dhe fushata të gjera informuese, duke arritur dhe në disa raste tejkalar objektivat e përcaktuara.

Një ndër kontributet më domethënëse ishte zhvillimi dhe lansimi i kuizit interaktiv online “Sfidoni detektorin e së vërtetës”, i integruar në platformën edukimimedial.dplus.org. Përmes këtij mjeti, D+ krijoi një hapësirë praktike dhe tërheqëse ku të rinjtë mund të testojnë, përmirësojnë dhe konsolidojnë aftësitë e tyre për verifikimin e fakteve dhe identifikimin e lajmeve të rreme.

Në terren, D+ organizoi 15 sesioneve informuese në shkollë të mesme, universitete dhe qendra rinore në mbarë Kosovën, duke përfshirë 328 të rinj. Përmes këtyre sesioneve, D+ kombinoi njohuritë teorike mbi edukimin medial me ushtrime praktike dhe demonstrime të platformës dhe kuizit interaktiv, duke krijuar një mjedis të angazhuar dhe pjesëmarrës që nxiti mendim kritik dhe interes të lartë nga të rinjtë.

Në kuadër të komunikimit publik, D+ realizoi një fushatë të strukturuar me 30 postime në rrjete sociale. Si rezultat, fushata arriti rreth 63,000 persona, duke tejkalar ndjeshëm objektivin fillestar prej 10,000 dhe duke zgjeruar ndikimin e projektit përtej aktiviteteve fizike.



Fushata arriti rreth 63,000 persona — duke tejkalar ndjeshëm objektivin fillestar prej 10,000.





Në kuadër të këtij projekti, D+ poashtu organizoi kampin veror me mbi 20 të rinjë nga komuna të ndryshme të Kosovës që synonte rritjen e aftësisë së të rinjve për t'u përballur me dezinformimin, duke i kushtuar vëmendje të veçantë votuesve për herë të parë gjatë proceseve zgjedhore. Gjatë tre ditëve intensive, pjesëmarrësit u trajnuan nga ekspertë vendorë dhe rajonalë mbi dezinformimin gjatë zgjedhjeve, teknikat e kontrollimit të fakteve dhe ndikimin e inteligjencës artificiale dhe deepfake-ve në demokraci.

Vlerësimet treguan se 43% e pjesëmarrësve përmirësuan rezultatet e tyre, ndërsa asnjë nuk shënoi rënie, duke konfirmuar ndikimin pozitiv të trajnimit.

Për më tepër, D+ mori pjesë në pesë emisione televizive dhe radiofonike kombëtare, duke rritur dukshëm shikueshmërinë dhe ndikimin e projektit.

Përmes INFO-s, D+ kontribuoi në ndërtimin e një brezi të ri që mendon kritisht, informohet me përgjegjësi dhe vepron kundër dezinformimit në hapësirat ku jeton dhe angazhohet.



7.2 Fuqizimi i të rinjve për edukimin medial

Në kuadër të misionit për fuqizimin e të rinjve dhe promovimin e qytetarisë aktive, D+ gjatë këtij viti ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e edukimit medial përmes organizimit të kampit dy-ditor për fuqizimin e të rinjve në fushën e edukimit medial. Ky aktivitet mblodhi mbi 80 të rinj nga komuna të ndryshme të Kosovës, duke krijuar një hapësirë gjithëpërfshirëse për shkëmbim idesh, zhvillim të mendimit kritik dhe rritje të vetëdijes për sfidat e botës digjitale.

Gjatë kampit, pjesëmarrësit u përfshinë në trajnime dinamike, ushtrime praktike dhe aktivitete interaktive në grupe, të dizajnuara për të forcuar aftësitë e tyre në identifikimin e dezinformimit, analizimin kritik të përmbajtjeve mediale dhe kuptimin e ndikimit të algoritmeve në formësimin e perceptimeve. Përmes metodave inovative dhe qasjes bashkëpunuese, D+ krijoi një mjedis ku të rinjtë jo vetëm mësuuan, por edhe reflektuan dhe sfiduan njëri-tjetrin, duke u përgatitur për të qenë qytetarë digjitalë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm.



Si vazhdimësi e këtij angazhimi, D+ zhvilloi edhe fushatën sensibilizuese “Kliko me Kujdes”, e cila vendosi në qendër zërin e vetë të rinjve. Përmes mesazheve të tyre autentike dhe përmbajtjeve kreative në rrjete sociale, të rinjtë u shndërruan në ambasadorë të edukimit digjital, duke promovuar kulturën e verifikimit të informacionit, mbrojtjes së privatësisë dhe përgjegjësisë online. Fushata krijoi një hapësirë të sigurt për dialog dhe reflektim, duke inkurajuar të rinjtë të angazhohen aktivisht në mbrojtje të integritetit informativ.



Ky aktivitet mblodhi mbi 80 të rinj nga komuna të ndryshme të Kosovës, duke krijuar një hapësirë gjithëpërfshirëse.



Përmes këtyre aktiviteteve, D+ vazhdon përkushtimin për të fuqizuar të rinjtë si aktorë të ndryshimit, duke investuar në ndërtimin e një hapësire digjitale të sigurt, të informuar dhe të bazuar në mendim kritik.

Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Të rinjtë e fuqizuar përmes shkollave dhe shoqërive gjithëpërfshirëse (YESS)”, i mbështetur financiarisht nga Fondi për Ndërtimin e Paqes, në partneritet me UNICEF dhe IOM.





8. Raportimet dhe ndreqjet në platformën ndreqe.com

Në platformën ndreqe.com, gjatë vitit 2025 qytetarët kanë raportuar mbi 250 ankesa. Raportimet e qytetarëve kanë qenë në të gjitha kategoritë: Ndriçim publik, Ujëra të zeza, Mbeturina, Ambient, Trotuar i dëmtuar, Gropë në rrugë, dhe të tjera.

Platforma ndreqe.com ka vazhduar të zhvillojë bashkëpunim të suksesshëm me disa komuna, duke përfshirë Komunën e Istogut dhe atë të Mitrovicës së Jugut.

Gjatë 2025, përveç postimeve të ndreqjeve, është realizuar edhe një kampanjë me video të shkurtra për të shënuar 8-vjetorin e themelimit të platformës. Përmbajtja përfshin mesazhe nga zyrtarët lokalë dhe falemnderime te dyte ndaj ndreqe.

Ndreqe vazhdon te jete platforme ku qytetaret mund te raportojne prishje.



Aktivite të tjera

Reflektim mbi fushatën e zgjedhjeve lokale në Kosovë

Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2025, D+ luajti rol kyç në analizimin e sfidave që lidhen me transparencën, financimin e fushatave dhe barazinë në garën zgjedhore. Përmes hulumtimeve, intervistave me kandidatë dhe analizës së praktikave në terren, D+ solli në vëmendje publike çështje si keqpërdorimi i mundshëm i resurseve publike, blerja e votës dhe pengesat financiare që përballen gratë dhe të rinjtë.

Gjetjet e publikuara theksuan nevojën për reforma të qarta ligjore, kufizime më të forta të shpenzimeve dhe mbikëqyrje më efektive, me qëllim që procesi zgjedhor të mbetet i drejtë, transparent dhe i bazuar në konkurrencë idesh.


[Klikoni këtu për të lexuar më shumë.](#)

Paraqitjet mediale

D+ ka realizuar gjithsej 77 paraqitje mediale lidhur me çështje të cilat lidhen me prokurim publik dhe 85 paraqitje në total, duke përfshirë edhe aktivite të tjera. Këto paraqitje kanë shërbyer për të informuar publikun mbi gjetjet e monitorimit, për të ngritur shqetësime mbi praktikat problematike dhe për të kontribuar në debatin publik mbi transparencën, llogaridhënien dhe sundimin e ligjit.

Pjesëmarrja në forume dhe ngjarje për demokraci dhe qeverisje të mirë

Gjatë vitit 2025, përfaqësuesit nga D+ kanë marrë pjesë aktive në një numër panelesh dhe forumesh të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në promovimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë. Këtu përfshihen pjesëmarrja në konferencën rajonale të ODIHR-it, dialogu rajonal për reformën administrative, si dhe aktivite të tjera në kuadër të mbrojtjes së demokracisë. Përmes këtyre angazhimeve, D+ ka kontribuar në adresimin e çështjeve kyçe për forcimin e transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe dialogut demokratik.



Pjesëmarrja e D+ në konferencën rajonale të ODIHR-it

D+ u përfaqësua nga Albert Krasniqi, Drejtor i Programeve, në konferencën rajonale të ODIHR-it “Ruajtja e integritetit zgjedhor në Ballkanin Perëndimor: Forcimi i mbikëqyrjes dhe besimit”, e mbajtur në Varshavë.

Gjatë prezantimit të tij, z. Krasniqi ndau përvojën e Kosovës, duke theksuar rolin qendror të shoqërisë civile në mbrojtjen e integritetit zgjedhor dhe në ndërtimin e besimit të qytetarëve ndaj proceseve zgjedhore.

Ai vuri në pah ndikimin e inovacioneve të hershme, përfshirë paraqitjen e rezultateve paralele të zgjedhjeve, të cilat kontribuuan në uljen e tensioneve, parandalimin e shpalljeve të parakohshme të fitores dhe nxitën modernizimin e sistemeve institucionale.

Po ashtu, ai rikujtoi kontributin e shoqërisë civile në avokimin për listat e hapura të kandidatëve në vitin 2010, duke forcuar rolin e votuesve në përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe duke ndikuar në riformësimin e përfaqësimit parlamentar. Për më tepër, u theksua se monitorimi i vazhdueshëm dhe mekanizmat e ankesave e shndërruan kuadrin ligjor zgjedhor në llogaridhënie konkrete, çka rezultoi me mbi 600,000 euro gjoba gjatë zgjedhjeve të fundit.

Në përmbyllje, u nënvizua se mobilizimi qytetar ka ndikuar në uljen e numrit të kandidatëve me probleme ligjore, duke reflektuar kërkesën në rritje të qytetarëve për integritet politik. Përvoja e Kosovës dëshmon se shoqëria civile luan një rol aktiv jo vetëm si vëzhguese, por edhe si inovatore, mbrojtëse dhe mobilizuese e proceseve demokratike.





Dialogu rajonal për reformën administrative

D+ organizoi konferencën e parë rajonale “Fuqia e Pjesëmarrjes: Reduktimi i Barrës Administrative përmes Angazhimit të Qytetarëve dhe Bizneseve në Ballkanin Perëndimor”, në kuadër të projektit “Promovimi i Procedurave Administrative të Drejta për Qytetarët dhe Bizneset”, i financuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë. Konferenca u realizua në bashkëpunim me Institutin EPIK, me mbështetjen e GIZ Kosovo dhe në partneritet të ngushtë me Zyrën për Planifikim Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Ngjarja mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, shoqërisë civile dhe sektorit privat nga Ballkani Perëndimor, duke ofruar një platformë për shkëmbimin e praktikave të mira në përmirësimin e shërbimeve publike, reduktimin e barrës administrative dhe forcimin e qeverisjes së përqëndruar te qytetarët dhe bizneset.

Diskutimet u fokusuan në qeverisjen gjithëpërfshirëse, transformimin digjital, bashkëpunimin rajonal dhe rolin e inteligjencës artificiale në modernizimin e administratës publike. Konferenca kontribuoi në forcimin e dialogut ndërinstitucional dhe në promovimin e zgjidhjeve inovative për shërbime publike më efikase dhe më të drejta në nivel rajonal.

Promovimi i ngrohjes së pastër

Në kuadër të projektit GENERATE, i udhëhequr nga Universiteti i Mançesterit, D+ organizoi punëtorinë “Drejt ngrohjes me zero emetime të karbonit në Kosovë: rrugë dhe perspektiva”, në Prishtinë. Punëtorja mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, shoqërisë civile, sektorit privat, akademisë dhe komunitetit energjetik për të diskutuar tranzicionin drejt sistemeve më të pastra dhe më të qëndrueshme të ngrohjes.

Diskutimet theksuan rëndësinë e iniciativave komunale, projekteve të energjisë së ripërtëritshme, efikasitetit energjetik dhe politikave gjithëpërfshirëse. U nënvizua se kalimi drejt ngrohjes së pastër kërkon bashkëpunim ndërsektorial dhe angazhim afatgjatë për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe të drejta në sektorin e energjisë.



Kostoja e Politikës në Kosovë

D+ në bashkëpunim me Westminster Foundation for Democracy (WFD), publikoi raportin “Kostoja e Politikës në Kosovë”, i cili analizoi ndikimin e kostove financiare në pjesëmarrjen politike dhe konkurrencën zgjedhore gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025.

Raporti konstatoi se kostot e kandidimit përbëjnë një barrierë të konsiderueshme për pjesëmarrjen politike. Mesatarja e shpenzimeve për kandidat ishte 9,463 euro, ndërsa kandidatët e zgjedhur shpenzuan mesatarisht 12,150 euro, krahasuar me 4,090 euro për kandidatët që nuk u zgjodhën. Këto gjetje dëshmuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet nivelit të shpenzimeve dhe suksesit elektoral, duke ngritur shqetësime për barazinë e mundësive dhe integritetin e konkurrencës zgjedhore.



9. Partnerët dhe donatorët

Aktivitetet dhe rezultatet e mësipërme nuk do të ishin të mundura pa mbështetjen, përkrahjen dhe partneritetin e organizatave të ndryshme vendore e ndërkombëtare.

Të gjitha raportet e auditimit të organizatës, janë të publikuara në faqen tonë: <https://dplus.org/per-ne/>

